



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE**

Nr. i Dokumentit: 22.15.1-2016-08

RAPORTI I AUDITIMIT

**PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË KOMUNËS SË
SUHAREKËS PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016**

Prishtinë, qershor 2017

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Suharekës në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Udhëheqësi i ekipit, Ramadan Gashi dhe Qëndresa Sogojeva-anëtare, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të auditimit Florim Beqiri.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	6
2 Qeverisja.....	9
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	14
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	22
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	23
Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	26
Shtojca IV:Letër konfirmimi	32

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetor të Komunës së Suharekës për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit¹, të datës 29.11.2016.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërdrejt cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i komunës. Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë *një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Theksim i Çështjes

Si Theksim i Çështjes dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj se komuna kishte bërë keq klasifikim të shpenzimeve ku nga kategoria e investime kapitale kishte bërë pagesa 225,847€ për mallra dhe shërbime, ndonëse të njëjtat ishin aprovuar me tabelat buxhetore në kategorinë e investimeve kapitale.

Po ashtu, vlera e pasurive nën 1,000€ e prezantuar në PFV (690,485€) nuk është e saktë për shkak se komuna nuk kishte aplikuar normat e drejta të zhvlersimit për këto pasuri.

Për më gjerësisht shih Pjesën 1.1 të këtij Raporti.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

¹ Termi “Plani i Jashtëm i Auditimit” është zëvendësim i termit “Memorandumi i Planifikimi të Auditimit”

Dëshirojmë të falënderojmë Kryetarin e Komunës dhe stafin e tij për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore janë:

Për shkak të rëndësisë së informatës lidhur me nënvlerësimin e pasurive dhe keq klasifikimin e shpenzimeve, ne e kemi theksuar opinionin e auditimit.



Kryetari duhet t'i analizojë arsyet për Theksimin e Çështjes në 2016 dhe t'i identifikojë veprimet që kërkohen për të mundësuar një prezantim të drejtë dhe të vërtetë të klasifikimit të shpenzimeve dhe pasurisë në 2017 (shih nënkapitullin 1.1).

Komuna nuk i kishte zbatuar rekomandimet e vitit të kaluar në shkallën e duhur.



Kryetari duhet të sigurojë se plani i veprimit po zbatohet me kohë për të gjitha rekomandimet e dhëna, dhe me fokus të veçantë tek ato me një rëndësi më të madhe, duke marr veprime aktive në implementimin e plotë të tyre. (shih çështjen 1).

Pyetësi i vetëvlerësimit i plotësuar nga stafi komunal, nuk ka identifikuar listën e rreziqeve të cilat mund të kanosin arritjen e objektivave dhe reagimet në rast të ndodhjes së tyre.



Kryetari duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve dhe sigurojë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek një drejtor përkatës i cili në koordinim me udhëheqësit e njësisë do të menaxhojë këtë proces dhe do të raportojë në baza të rregullta (shih çështjen 2).

Pasqyra e shpenzimeve të fondeve, paraqet nivelin e ekzekutimit të buxhetit për investimet kapitale 79%. Po ashtu, shpenzimi nga të hyrat vetjake prej 62%, tregon se komuna nuk ka arritur të përfundojë projektet e planifikuara me burime vetjake



Kryetari duhet të bëjë një vlerësim gjithëpërfshirës të burimeve potenciale të të hyrave dhe shpenzimeve, dhe të përcaktoj opsione praktike për përmirësimin e ekzekutimit për vitin 2017. Një monitorim sistematik i trendeve buxhetore do të rrishte mundësitë për një performancë më efektive (shih çështjen 5).

Përgjigja e Menaxhmentit në auditimin 2016

Kryetari i Komunës ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit në këtë raport, si dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet e dhëna.

Ne e konsiderojmë si të kryer faktin që Kryetari:

- Do ta shqyrtoj raportin e auditimit në Asamblenë Komunale; dhe
- Deri në fund të muajit janar 2018, ta diskutoj në Asamblenë Komunale progresin lidhur me implementimin e Planit të Veprimit për rekomandimet e auditimit, para se PVF 2017 të jenë dorëzuar në Ministrinë e Financave.

1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Kemi audituar PFV-të komunës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të PFV-ve.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinion

Kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj se komuna kishte bërë keq klasifikim të shpenzimeve ku nga kategoria e investime kapitale kishte bërë pagesa 225,847€, të cilat i takojnë mallrave dhe shërbimeve. Prej tyre, më kryesoret janë: ofrimi i shërbimeve mjekësore (90,000€), mirëmbajtje dhe pastrim i qytetit (33,554€), mirëmbajtja dimërore e rrugëve (60,000€). Këto vlera ishin të aprovuar me tabelat buxhetore të Buxhetit 2016 si investime kapitale, por projektet e paraqitura në tabela, nuk përmbushin kushtet të trajtohen si projekte kapitale. Gabimet kanë të bëjnë me planifikimet fillestare nga komuna dhe aprovimet jo adekuate nga ana e MF.

Po ashtu, vlera e pasurive nën 1,000€ e prezantuar në PFV 2016 (690,485€) nuk ishte e saktë në krahasim me pasuritë nën 1,000€ të vitit 2015 (2,512,088€), për shkak se të gjitha pasuritë e blera deri në vitin 2009, në vitin 2016 ishin zhvlerësuar me normë 90%. Zhvlerësimi i tillë nuk është i drejtë sepse sipas rregullores për menaxhimin e pasurive, secila pasuri është dashur të zhvlerësohet sipas normave (viteve) të përcaktuara.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se PFV nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që ekziston. Keq-deklarimet mund të

rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalsjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e PFV nga komuna, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e komunës, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të komunës.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të PFV.

1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Pasqyrat Nëntëmujore me kohë;
- Planin e Prokurimit për vitin 2016; dhe
- PVF janë përgatitur me kohë dhe nënshkruar nga ZKA dhe ZKF.

Në kontekst të kërkesave për raportim, ne nuk kemi identifikuar ndonjë parregullsi.

Nga aspekti i cilësisë, draft PFV-të fillestare kanë pas nevojë të korrigjohen për shkak se përmbanin disa gabime dhe mangësi informatash. Ato janë korrigjuar, me përjashtim të çështjeve të pasurive dhe keq klasifikimit për të cilat çështje ne e kemi theksuar opinionin. Për më shumë, shih nënkaptullin 1.1 Opinioni i auditimit.

DEKLARATA E BËRË NGA MENAXHMENTI I KOMUNËS

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtarit Financiar, me rastin e dorëzimit të draft PFV-ve në Ministrinë e Financave, është e saktë për shkak se gjatë auditimit nuk janë identifikuar gabime materiale, përveç çështjeve të përmendura në opinion e auditimit të cilat ne i kemi konsideruar jo materiale.

1.3 Rekomandimet për pjesën e parë të raportit

Rekomandimi 1 Kryetari duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2017 i adreson të gjitha çështjet e ngritura në raport. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PVF-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat ku janë identifikuar gabime në klasifikimin e shpenzimeve dhe pasuritë.

2 Qeverisja

Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për komunën që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon përkushtimin e menaxhmentit në zhvillimin e proceseve ekzistuese dhe kontrolleve. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vetëvlerësimit që plotësohet nga të gjitha organizatat buxhetore siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një organizatë individuale buxhetore të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekzistojnë disa dobësive të qeverisjes brenda komunës veçanërisht në lidhje me menaxhimin e rrezikut. Lista kontrolluese e vet-vlerësimit, e plotësuar nga komuna, e pasqyron këtë situatë vetëm pjesërisht, me disa komente pozitive mbi ekzistimin e aranzhimeve ekzistuese që nuk bazohen në dëshmi.

Komuna nuk e kishte hartuar planin strategjik dhe nuk kishte hartuar listën e rreziqeve me të cilën mund të ballafaqohet komuna.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit. Komuna nuk kishte arrit t'i zbatoj në shkallën e mjaftueshme rekomandimet e vitit të kaluar. Vetëm 4 nga 14 ishin zbatuar plotësisht dhe nuk kishte ndonjë plan të rishikimit të rekomandimeve.

Pyetësi i vetëvlerësimit - Komuna ka marrë në konsideratë kërkesat ligjore të parapara me rregullat e MFK-së dhe ka përfunduar me kohë vetëvlerësimin që është kryer nga Kryetari i Komunës dhe Zyrtari kryesor financiar, por ka nevojë të përfshijë një vlerësim më kritik ndaj arritjes së rezultateve.

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PFV të vitit 2015, ka rezultuar me 14 rekomandime, prej të cilave 12 ishin me prioritet të lartë dhe 2 me prioritet të mesëm. Komuna kishte zbatuar kërkesën për të përgatitur një Plan Veprimi brenda 30 ditëve pas pranimit të raportit të auditimit për PFV për vitin 2015 të ZKA, ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen rekomandimet. Raporti i auditimit për PFV e vitit 2015 ishte diskutuar edhe në Kuvendin Komunal me procesverbalin e datës 20.07.2016.

Deri në fund të auditimit tonë, 4 (katër) rekomandime janë zbatuar (3 me prioritet të lartë dhe 1 me prioritet të mesëm), 4 (katër) rekomandime me prioritet të lartë janë në proces të zbatimit dhe 6 (gjashtë) rekomandime nuk janë zbatuar (5 me prioritet të lartë dhe 1 me prioritet të mesëm). Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shih Shtojcën III.

Çështja 1 – Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë

E gjetura Nga të dhënat më sipër shihet se vetëm një numër i vogël i rekomandimeve janë zbatuar dhe disa ishin në proces e sipër. Niveli aktual i trajtimit të rekomandimeve nuk është i kënaqshëm për shkak se menaxhmenti nuk kishte ndërmarr veprime të nevojshme në rishikimin, monitorimin e një procesi konfirmues për shkallën e zbatimit të rekomandimeve dhe identifikimin e pengesave për veprim në adresimin e tyre të plotë.

Rreziku Përsëritja e rekomandimeve nga viti i kaluar tregon për dobësi të vazhdueshme të kontrolleve të brendshme në sisteme kryesore financiare që kanë rezultuar me:

- Keq klasifikim të shpenzimeve;
- Të hyrat nga qiratë komunale; dhe
- Trajtimi i llogarive të arkëtueshme.

Rekomandimi 2 Kryetari duhet të vendos dha zbatoj mekanizma konkret të llogaridhënies ndaj të gjithë personave përgjegjës të ngarkuar për zbatimin e rekomandimeve. Pas pranimit të këtij raporti, ne sugjerojmë që të përgatitet një plan i rifreskuar i veprimit për të zbatuar rekomandimet e këtij viti dhe rekomandimet e vitit të kaluar, duke përcaktuar qartë afatet kohore, veprimet dhe personat përgjegjës për realizimin e këtij plani. Një proces monitorimi, po ashtu duhet zbatohet.

2.2 Pyetëtori i vetëvlerësimit të komponentave të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një listë të detajuar të vet-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vet-vlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministri, duke vlerësuar nga një pyetje kyçe në secilën komponentë të listës kontrolluese. Ne kemi përmbledhur të gjeturat tona për komunën më poshtë dhe përmbledhja e punës sonë nuk ka për qëllim të ofroj komente për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vet-vlerësimit, por do të pasqyrojë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për të mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Çështja 2 – Pyetësi i vet-vlerësimit – Prioritet i lartë

E gjetura Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar çështjet kyçe të pyetësit të vet-vlerësimit në lidhje me pesë komponenta. Për pyetjet e shqyrtuara kemi gjetur se çështjet nuk ishin adresuar plotësisht ishin si në vijim:

1. Pyetësi i vet-vlerësimit i plotësuar ka konfirmuar se komuna ende nuk ka identifikuar listën e rreziqeve të cilat mund të kanosin arritjen e objektivave dhe reagimet në rast të ndodhjes së tyre;
2. Komuna nuk ka hartuar strategjinë gjithëpërfshirëse të zhvillimit. Me aktvendim 01-Nr.16-6168 të datës 17.08.2016 komuna kishte formuar grupin punues për hartimin e strategjisë për qeverisje dhe zhvillim 2018/2022.
3. Lidhjet në mes të planit të prokurimit dhe buxhetit (PIP) nuk janë të harmonizuara njëra me tjetrën.

Auditimi i Brendshëm i ka theksuar çështjet më lartë. Për më shumë, veprimi i ndërmarrë nga menaxhmenti për adresimin e çështjeve të identifikuara nga NJAB ishte i kufizuar. Kjo situatë ka ndodhur për shkak të mungesës së qartësisë nga menaxhmenti që ka të bëjë me rëndësinë e pyetësit të vet-vlerësimit dhe me atë se kush është zyrtari përgjegjës që i përdorë këto mekanizma për t'i mbështetur përmirësimet operative.

Rreziku Aranzhimet e dobëta të qeverisjes ndikojnë në dobësimin e proceseve strategjike dhe operative dhe e zvogëlojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët përmes aktiviteteve joefikase dhe joefektive.

Rekomandimi 3 Kryetari duhet të sigurojë se do të hartohet lista e rreziqeve dhe plani i zhvillimit strategjik. Monitorimi i strategjisë duhet të bëhet në baza të vazhdueshme për tu siguruar se objektivat strategjike janë duke u arritur. Njësia e auditimit të brendshëm duhet të përfshihet në procesin e rishikimit për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese.

2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit komuna operon dhe sfidat me të cilat përballet.

2.3.1 Përcaktimi i objektivave strategjike

Komuna ka hartuar disa dokumentesh strategjike si: Planin Zhvillimor Komunal 2008-2018, Planin Zhvillimor Urban 2008-2018 dhe Planin Operativ Emergjent Lokal, ndërsa plani strategjik kundër korrupsionit nuk është hartuar nga Kuvendi Komunal.

Çështja 3 – Dokumentet strategjike - Prioritet i lartë

- E gjetura** Komuna nuk posedon një plan strategjik gjithëpërfshirës me objektiva afatgjate ku përshkruhet qartë Vizioni dhe Misioni i cili prezanton orientimin dhe synimet e komunës në një periudhë afatmesme të zhvillimit.
- Rreziku** Mungesa e një plani strategjik gjithëpërfshirës vështirëson përcaktimin e prioriteteve kyçe të cilat kanë të bëjnë me orientimin dhe zhvillimin e Komunës në periudha afatgjate. Paqartësia mbi zbatimin e strategjisë, bën të pamundur që të përcillet përmbushja e objektivave në pikëpamje të vizionit të komunës si një ndër kushtet esenciale të qeverisjes së mirë.
- Rekomandimi 4** Kryetari duhet të siguroj se do të hartoj një plan të përgjithshëm strategjik për komunën duke përfshirë koston e strategjisë, të përcaktojë objektivat afatgjate dhe të shërbej si platformë orientuese për hartimin e planeve vjetore. Të hartoj planin e veprimit për monitorimin e arritjes së objektivave, duke vendosur funksione efektive të mbikëqyrjes.

2.3.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Komuna i posedon raportet e rregullta mujore që bëhen nga drejtorët dhe zyrtarët kyç, të cilat dërgohen tek Kryetari. Përveç këtyre, komuna ka raporte 3, 6, 9 mujore dhe raportin vjetor financiar që aprovohen në Kuvendin e Komunës si dhe raportin mbi progresin e investimeve kapitale (3 mujor dhe vjetor) si kërkesë ligjore.

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

Komuna e ka të themeluar NJAB e cila funksionon me një auditor të licencuar. Po ashtu, komiteti i auditimit ishte themeluar 26.12.2013 dhe kishte mbajtur katër (4) takime. NjAB kishte hartuar planin strategjik (2016/2018) si dhe planin vjetor të auditimit.

NjAB për vitin 2016 ka planifikuar dhe kryer gjashtë (6) auditime të rregullta, ndërsa ka kryer 8 auditime dhe (1) auditim me kërkesë të kryetarit. Raportet janë përfunduar me kohë dhe si fusha rishikimi kanë qenë: (1) Menaxhimi i Prokurimit – (Fushëveprimi; viti 2015); (2) Menaxhimi i automjeteve dhe i shpenzimeve për derivate – (Fushëveprimi; shkurt-2016); (3) Menaxhimi i procesit të faljes së borxheve – (Fushëveprimi; shkurt/2015, prill/2016); (4) Rregullsitë lidhur me kalkulimin e detyrimeve dhe grumbullimi i të hyrave nga tatimi në pronë, taksat në aktivitet për subjektet afariste dhe qiratë – (Fushëveprimi; 2016); (5) Rregullsitë lidhur me menaxhimin e të hyrave dhe shpenzimeve në drejtorinë e arsimit – (Fushëveprimi; 2016); (6) Rregullsitë lidhur me menaxhimin e të hyrave dhe shpenzimeve në QKMF – (Fushëveprimi; 2016); (7) Rregullsitë lidhur me menaxhimin e aktiviteteve të prokurimit – (Fushëveprimi; 2016); (8) Menaxhimi lidhur me

rregullsitë e grumbullimit e të hyrave vetjake, pagesat shitesë për punëtorë të angazhuar në mësimin për arsimin dhe aftësimin për të rritur - (Fushëveprimi; 2016); (9) Zbatimi i procedurave lidhur me identifikimin evidentimin, klasifikimin, barazimin dhe mirëmbajtjen e pronës së komunës në libra të pasurisë - (Fushëveprimi; 2016).

Çështja 4 - Zbatimi i rekomandimeve të NjAB - Prioriteti i lartë

- E gjetura** Ne kemi vërejtur se menaxhmenti kishte bërë plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhënë nga NJAB, mirëpo zbatimi i tyre ishte i dobët. Po ashtu, komiteti i auditimit ishte takuar katër (4) herë, ku kishte komentuar gjetjet e auditimit, mirëpo nuk kishte nxjerrë konkluzione për menaxhmentin për të treguar se çfarë veprimesh duhet të ndërmerret për zbatimin e tyre.
- Rreziku** Mos adresimi i rekomandimeve të dhëna nga NJAB, rritë rrezikun që dobësitë e identifikuar të mos korrigjohen, dhe rekomandimet e njëjta të përsëriten. Mungesa e konkluzioneve për menaxhmentin nga komiteti i auditimit, rrit rrezikun që menaxhmenti të mos jetë i informuar për të ndërmarrë masat adekuate për çështjet e ngritura nga auditimi.
- Rekomandimi 5** Kryetari duhet të siguroj hartimin dhe zbatimin e planeve të veprimit sipas sektorëve dhe të reagoj në gjetjet dhe rekomandimet e dhëna nga auditimi i brendshëm, dhe në baza mujore t'i monitoroj ato. Komiteti i auditimit në procesverbalet e takimeve, të nxjerrë konkluzione të qarta për menaxhmentin lidhur me çështjet e auditimit të brendshëm.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin 2, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në komunë. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe të arkëtueshmet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Komuna ka të ndërtuar një sistem të kontrollit të brendshëm i cili në përgjithësi operon mirë, por efektiviteti i kontrolleve ka nevojë të përmirësohet në disa fusha të caktuara ku janë identifikuar mangësi.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Në i kemi shqyrtuar të hyrat e arkëtuara, burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Pranimet	2015 Pranimet	2014 Pranimet
Të hyrat vetjake	1,917,000	1,917,000	1,786,172	1,815,740	1,632,052

Në totalin (1,786,172€) e të hyrave vetjake të mbledhura janë të përfshirë, gjobot e gjykatave dhe dënimet e policisë (228,159€). Të hyrat e planifikuara për vitin 2016 ishin mbledhur në shkallën prej 93%, çka paraqet një performancë jashtëzakonisht të lartë.

Tabela 2. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Burimet e Fondeve:	13,297,920	13,757,154	12,773,770	13,587,676	12,948,971
Granti i Qeverisë - Buxheti	11,380,920	11,394,936	11,384,240	11,617,541	11,511,488
Të bartura nga viti paraprak ³	-	441,937	221,439	564,518	242,815
Të hyrat vetjake ⁴	1,917,000	1,917,000	1,164,855	1,389,739	1,194,668
Donacionet e brendshme	-	-	-	465	-
Donacionet e jashtme	-	3,281	3,236	15,413	-

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 459,234€. Kjo është si rezultat i rritjes së Grantit Qeveritar prej 14,016€, ku me vendim të Qeverisë Nr.11/120 të datës 14.12.2016 janë dhënë për mbulimin e shpenzimeve për subvencione, të hyrat e bartura prej 441,937€, si dhe donacioneve të jashtme me vlerë 3,281€.

Të hyrat e bartura nga viti 2015 ishin 441,937€, ku pjesa më e madhe ishte ndarë për investime kapitale (432,087€), mallra & shërbime dhe komunalit (9,380€) dhe subvencionet (468€).

Shpenzimi të hyrave në total (të bartura dhe të vitit 2016) ishte 62%. Kjo tregon se komuna nuk ka arritur të përfundojë projektet me kohë të cilat ka planifikuar të realizoj nga të hyrat vetjake.

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

³ Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁴ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

Tabela 3. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	13,297,920	13,757,154	12,773,770	13,587,676	12,948,971
Pagat dhe Mëditjet	7,878,077	7,998,261	7,940,567	7,759,732	7,061,677
Mallrat dhe Shërbimet	1,003,850	1,000,370	965,003	913,344	921,359
Shërbimet komunale	262,000	258,803	249,143	209,235	227,360
Subvencionet dhe Transferet	280,999	299,118	298,137	286,746	298,120
Investimet Kapitale	3,872,994	4,200,602	3,320,920	4,418,619	4,440,455

Buxheti final për vitin 2016 ishte ekzekutuar në nivelin 93% të planifikimit. Kjo konsiderohet një performancë shumë e mirë e ekzekutimit buxhetor. Shkalla e ngjashme e ekzekutimit të buxhetit ishte edhe dy vitet e kaluara (95% në vitin 2015 dhe 92% në vitin 2014).

Megjithatë, konkluzionet e auditimit kanë identifikuar ngecje të shpenzimeve për projekte kapitale dhe të hyrave vetjake.

Çështja 5 - Dobësi në ekzekutimin e buxhetit dhe shpenzim i ultë i të hyrave vetjake - Prioriteti i lartë

E gjetura Buxheti për shpenzime kapitale ishte shpenzuar 79%. Një shfrytëzim relativisht i ultë i buxhetit për kapitale është i paarsyeshëm për faktin se komuna kishte buxhet të mjaftueshëm nga të hyrat vetjake (841,815€), të cilat nuk i kishte shpenzuar në 2016, por i kishte bartur për t'u shpenzuar në vitin 2017.

Rreziku Ekzekutimi i dobët i buxhetit do të rezultojë me shfrytëzim joefikas të burimeve financiare të komunës dhe në reduktimin e projekteve të planifikuara që të realizohen gjatë vitit.

Rekomandimi 6 Kryetari duhet të sigurohet që me rastin e planifikimeve buxhetore, të bëhet një vlerësim gjithëpërfshirës i burimeve potenciale dhe të përcaktoj opsione praktike për përmirësimin e ekzekutimit të buxhetit për investime kapitale për vitin 2017. Një monitorim sistematik i trendeve buxhetore do të rrishte mundësitë për një performancë më efektive.

3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna në 2016 ishin 1,786,172€. Krahasuar me vitin e kaluar (1,815,740€) kemi një rënie në inkasimin për rreth 2%.

Çështja 6 - Tatimi në pronë - Prioritet i mesëm

E gjetura Për vitin 2016, komuna kishte planifikuar që të realizoj 665,000€, ndërsa kishte arritur të inkasoj 696,629€. Ne kemi testuar 16 mostra nga tatimi në pronë dhe nga kjo kemi vërejtur se borxhet për vitin 2016 nga mostrat e përzgjedhura ishin 1,459€. Borxhet totale të akumuluarra nëpër vite për tatimin në pronë ishin 2,141,161€.

Komuna nuk ka arrit të kryej verifikimin e 1/3 të pronave të paluajtshme, siç kërkohet me Ligjin për tatimin në pronën të paluajtshme nr. 03/L-204, dhe udhëzimin administrativ në fuqi. Sipas zyrtarëve komunal mos verifikimi i pronës ka ndodhur për shkak të mungesës të anketuesve në terren për verifikim të pronave.

Rreziku Tatimi në pronë është burimi kryesor i të hyrave të komunës, prandaj duhet të trajtohet me kujdes plani i inkasimit, sepse ka ndikim direkt edhe në realizimin e projekteve kapitale dhe financimeve tjera të parashikuara nga ky burim.

Mos verifikimi i 1/3 të pronave mund të rezultojë me mangësinë e informatave të plota të pronës së tatueshme aktuale, me ndikimin e mundshëm që të hyrat e vlerësuara për tatimin në pronë të ulen.

Rekomandimi 7 Kryetari duhet të siguroj një rishikim të sistemeve ekzistuese për të konfirmuar nëse mekanizmat e vendosur për mbledhjen e të hyrave janë adekuat dhe mund të funksionojnë në mënyrë efektive. Verifikimi i pronave komunale duhet të bëhet siç parashihet me ligj.

Çështja 7 - Kontrollë të dobëta në qiradhëniet komunale - Prioritet i lartë

- E gjetura** Në 11 mostrat e testuara për pronat e dhëna me qira kemi vërejtur se 10 obligues nuk i kishin kryer obligimet ndaj komunës për pronën që shfrytëzojnë sipas kontratës. Obligimi i shfrytëzuesve ish në 131,633€. Menaxhmentit nuk kishte ndërmarr veprimet e duhura për t'i obliguar këta obligues që t'ju përmbahen kontratave të qirasë të lidhura me komunën.
- Rreziku** Kontrollët financiarë lidhur me inkasimin e qirave janë të dobëta për të siguruar zbatimin efektiv të kontratave. Vazhdimi i praktikave të tilla mund të nxit edhe obliguesit tjerë t'i shmangen pagesës së qirave. Mos realizimi i të hyrave të planifikuara rritë rrezikun e dështimit të projekteve të planifikuara nga burimet vetjake.
- Rekomandimi 8** Kryetari duhet të siguroj se do të rishikohen kontratat për qiradhënie dhe do të hartohet një plan masash ku do të përcaktohen afatet kohore shtesë për kryerjen e pagesave dhe përgjegjësit për zbatimin e masave të propozuara në mënyrë që të mblidhen borxhet e mbetura, si dhe në baza të rregullta të inkasohen borxhet aktuale. Në të kundërtën, shfrytëzimi i pronave publike nuk duhet lejuar.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti i planifikuar për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte 7,998,261€, ndërsa shpenzimet 7,940,567€ apo 99%.

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Ne testuam pajtueshmërinë e listave të pagave me sistemin e pagave, (punëtorët aktual, rekrutimet, largimet, pushimet e lehonave, pensionet, dhe pagesat për këshilltarët komunal). Po ashtu, kemi rishikuar nëse punonjësit janë paguar sipas kontratës.

Çështja 8 - Dosjet e mësimdhënësve - Prioritet i mesëm

E gjetura Gjatë testimit të dosjeve tek personeli i arsimit kemi vërejtur se dosjet e mësimdhënësve nuk ishin të kompletuara, pasi që mungonte vlerësimi i punëtorëve në të gjitha rastet. Vlerësimi i mësimdhënësve kërkohet me Udhëzimin Administrativ nr. 14/2013. Më tutje, në disa raste në dosjet personale të mësimdhënësve mungonte vendimi për përvojën e punës dhe vendimet për pushim vjetor.

Në dy raste, komuna nuk iu kishte dhënë mësimdhënësve kontratë në kohë të pacaktuar edhe pse ata i plotësojnë kushtet ligjore për t'u pajisur me një kontratë të tillë.

Rreziku Të dhënat në dispozicion nuk ofrojnë sigurinë e mjaftueshme se pagesat e pagave bëhen konform të dhënave të përditësuara të personelit arsimor. Kjo rrit rrezikun që stafi arsimor mos të paguhet në bazë të kontributeve dhe përvojës, apo në rastin tjetër, të paguhet më shumë sesa duhet.

Rekomandimi 9 Një shqyrtim sistematik i Dosjeve të Personelit në arsim duhet të ndërmerret, për të siguruar se i tërë dokumentacioni i nevojshëm është përfshirë në dosje. Vlerësimi i punëtorëve duhet të kryhet çdo viti shkollor, dhe po ashtu të gjithë mësimdhënësit që i plotësojnë kushtet ligjore, të pajisen me kontratë në kohë të pacaktuar.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe shërbime komunale në vitin 2016 ishte 1,259,174€. Prej tyre ishin shpenzuar 1,214,147€, apo 96%, apo 2% më pak se në vitin 2015. Për mostrat tona nuk kemi vërejtur ndonjë çështje për t'u raportuar.

Rekomandim

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 299,118€, të cilat pothuajse në tërësi ishin shpenzuar, në nivel të ngjashëm me atë të vitit 2015. Për mostrat e testuar nuk kemi hasur ndonjë çështje për tu raportuar

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 4,200,602€. Prej tyre në 2016 ishin shpenzuar 3,320,920€ apo 79%. Krahasuar me vitin 2015 (85%), kemi një rënie në shpenzim të buxhetit në këtë kategori për 6%. Për mostrat e testuar nuk kemi ndonjë çështje për t'u raportuar

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.2 Pasuritë

3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Në PVF komuna kishte paraqitur pasurinë mbi 1,000€ në vlerë 280,970,065€, ndërsa atë nën 1,000€, vlerën 690,000€.

Çështja 9 - Menaxhimi i pasurive përmes softuerit E-pasuria - Prioritet i lartë

E gjetura Sistemi i E-pasurisë ende nuk funksionon plotësisht për faktin se në E-pasuri nuk janë të regjistruar pasuritë që komuna i kishte blerë deri në vitin 2009.

Rreziku Mosfunksionimi i plotë i sistemit të e-pasurisë, vështirëson menaxhimin dhe kontrollin e pasurive në dispozicion, dhe rrit rrezikun e humbjes dhe keqpërdorimit të pasurive.

Rekomandimi 10 Kryetari duhet të siguroj funksionalizimin e sistemit të E-pasurisë dhe të fuqizoj kërkesat që të gjitha pasuritë nën 1,000€ të regjistrohen në këtë sistem. Nëse sistemi për arsye teknike nuk mund të përdoret, të dhënat mbi pasuritë dhe stoqet duhet të evidentohen dhe përditësohen në ndonjë program tjetër, duke mos e përjashtuar programin Excel.

3.2.2 Të arkëtueshmet

Komuna nuk ka arritur t'i arkëtoj të gjitha borxhet për të cilat ka ofruar shërbime. Struktura e llogarive të arkëtueshme përbëhet kryesisht nga: tatimi në pronë, qiratë nga lokalet/banesat dhe taksat në aktivitetin të biznesit. Mungesa e politikave adekuate dhe masave konkrete për mbledhjen e të hyrave, ka rezultuar me nivele të larta të llogarive të arkëtueshme.

Çështja 10 - Trajtimi i llogarive të arkëtueshme - Prioritet i lartë

- E gjetura** Lista e debitorëve ndaj komunës, sipas të dhënave të PFV ishte 4,446,637€. Pjesa më e madhe e këtyre llogarive kanë të bëjnë me tatimin në pronë (2,141,161€), taksa në biznes (1,859,786), renta e tokës (136,890€) dhe qiraja komunale (306,800€). Krahasuar me vitin e kaluar (4,352,000€) llogaritë e arkëtueshme ishin rritur për 94,637€. Kjo është si pasojë e mungesës së mekanizmave adekuat nga ana e komunës për t'i inkasuar borxhet e mbetura.
- Rreziku** Mungesa e masave konkrete për të inkasuar llogaritë e arkëtueshme, ka rezultuar me rritjen e këtyre llogarive prej vitit në vit dhe rrjedhimisht edhe me të hyra të reduktuara për komunën. Gjithashtu, kjo redukton edhe fleksibilitetin e komunës ndaj shpenzimeve të planifikuara që financohen nga të hyrat vetjake.
- Rekomandimi 11** Kryetari duhet të shqyrtoj ngritjen e një grupi pune të veçantë për shqyrtimin e inkasimit të borxheve. Komuna duhet të bëjë një analizë në mënyrë që të identifikoj shkaktarët e dështimit në pagesën e borxheve, të miratoj një strategji me masa konkrete si dhe të shfrytëzojë të gjitha mjetet në dispozicion, duke përfshirë edhe veprimet ligjore.

3.3 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2016 ishte 101,771€. Në përgjithësi komuna ka kontrollë të mira në menaxhimin e obligimeve. Vlera e mbetur si obligim është për shkak se pjesa më e madhe e faturave kishin arritur në muajin dhjetor, kështu që komuna nuk kishte pasur mundësi t'i paguaj ato dhe si rezultat janë bartur për t'u paguar në vitin 2017.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.1 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keq deklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
2. Pasqyrat Financiare	Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet që kanë ndikuar në Theksim të Çështjes. Duhet të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe pragmatike për t'i hequr gabimet në klasifikimin e shpenzimeve jo-kapitale.			X
2.3 Zbatimi i Rekomandimeve nga viti Paraprak	Kryetari duhet të monitoroj në mënyrë sistematike zbatimin e planit të veprimit dhe të identifikoj arsyet pse i njëjti nuk është zbatuar. Plani i hartuar pas pranimin të këtij raporti, duhet të përcaktoj saktë afatet kohore për implementimin e rekomandimeve , dhe stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.		Nga 14 rekomandime 4 janë zbatuar plotësisht, 4 ishin në proces dhe 6 të pazbatuar.	

2.4 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit	Kryetari duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetëvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Një rol ndihmës në ngritjen e cilësisë dhe konfirmimit të pohimeve në pyetësonin e vetëvlerësimit, mund të ofroj auditimi i brendshëm përmes rishikimit përfundimtar.		Është bërë rishikimi i listës kontrollues të vetëvlerësimit, ndërsa nuk është hartuar strategjinë gjithëpërfshirëse të zhvillimit dhe nuk ka listë të rreziqeve.	
2.5.1 Menaxhimi i Rrezikut	Kryetari duhet të sigurojë se pas hartimit të një liste të rreziqeve me nivelet përkatëse, përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut është deleguar tek një drejtor përkatës i cili në koordinim me udhëheqësit e njësive do të menaxhoj dhe do të raportoj në baza të rregullta mbi mbarëvajtjen e procesit.			X
2.5.2 Kontrollat Menaxheriale	Kryetari duhet ta bëjë një rishikim të rregullimeve ekzistuese të llogaridhënies dhe të kërkesave për raportim të vendosura mbi Drejtorinë e komunës dhe të implementojë aranzhime më të mira për arritjen e objektivave të specifikuar dhe për të	X		

	përmirësuar qeverisjen e mirë në të gjithë komunën.			
2.6 Sistemi i Auditimit të Brendshëm	Për të arritur përfitimin maksimal nga shërbimet e auditimit të brendshëm, Kryetari duhet të rishikojë nevojën që planet e auditimit të brendshëm të përshtaten me kërkesat që auditimi i brendshëm të ndjekë aktivitetet gjatë vitit aktual dhe që planet e veprimit të hartohen nga të gjitha njësitë e audituara në mënyrë që rekomandimet e dhëna të implementohen. Gjithashtu, kërkohet një rol më aktiv i Komitetit të Auditimit.		NJAB ka kryer auditime për vitin aktual dhe ka hartuar planin e veprimit, ndërsa komiteti i auditimit nuk ka qënë aktiv në adresimin e çështjeve tek kryetari.	
3.4 Prokurimi	Kryetari duhet të inicioj një shqyrtim të hollësishëm të të gjitha rasteve të përmendura më lartë për të analizuar pse kërkesat ligjore dhe rregullat e prokurimit nuk janë zbatuar dhe të merr masa përgjegjësie ndaj personave që mund t'i kenë shkaktuar komunës humbje të konsiderueshme financiare. Gjithashtu, duhet vlerësuar pse kontrollet e certifikimit kanë dështuar në parandalimin e pagesave të parregullta, siç ishte rasti me pagesat e derivateve dhe blerjeve pa kontratë.	X		

3.5 Shpenzimet Jo përmes Prokurimit	Kryetari duhet të sigurojë që marrëveshjet mes komunës dhe OJQ-ve të rishqyrtohen. Duhet të sigurohet se subvencionimi bëhet në harmoni të plotë me rregulloren për subvencione të komunës dhe çdo shmangie nga kjo rregullore do të analizohet dhe gabimet të korrigjohen. Rregulloret e komunës duhet të jenë të qarta dhe të përcaktojnë kriteret dhe shumën e lejuar për të bursave.			X
	Kryetari të siguroj se udhëtimet zyrtare jashtë bëhen vetëm sipas Udhëzimeve për udhëtime zyrtare dhe se nuk bëhen pagesa jashtë shpenzimeve të parapara me këto udhëzime. Kryetari të siguroj se të gjithë të punësuarit në komunë kompensohen për punën vetëm sipas ligjit.	X		
3.5.1 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Kryetari të ndërmarr masa konkrete për të siguruar një raportim të rregullt të departamenteve dhe të siguroj raporte përmbledhëse nga departamenti i burimeve njerëzore dhe të siguroj një proces të rregullt	X		

	lidhur me rekrutimin dhe menaxhimin e personelit në komunë.			
3.5.2 Subvencionet dhe Transferet	Kryetari duhet të vendosë kritere të qarta lidhur me trajtimin e kërkesave për subvencione. Të sigurohet që me rastin e subvencioneve të lejuara të kërkojnë që të përpilohen raporte përshkruese bashkangjitur me dëshmi dhe fatura për arsyeshmërinë e shpenzimeve dhe të përcillen aktivitetet për të cilat është lejuar subvencionin.			X
3.6 Të hyrat	Kryetari të vendosë kontrolle të brendshme shtesë në fushën e mbledhjes, barazimit dhe raportimit të të hyrave vetjake. Gjithashtu, zyra e tatimit në pronë të shfrytëzoj të gjitha burimet për verifikim të pronave sipas rregulloreve dhe udhëzimeve administrative. Falja e borxheve të bëhet bazuar në ligjet në fuqi dhe vendimeve të bazuara në rregullore.			X
3.7.2 Trajtimi i Llogarive të arkëtueshmëve	Kryetari duhet të merr masa të menjëhershme që me zyrtarët përgjegjës financiar të shqyrtoj arsyet e mos prezantimit në PVF të këtyre llogarive. Procesi i monitorimit			X

	<p>sistematik të bilanceve, masave dhe politikave për rritjen e inkasimeve, duhet të jetë gjithashtu pjesë e shqyrtimeve të rregullta të menaxhmentit. Ne, në auditimin e radhës do të kemi në vëmendje të veçantë masat që ka marrë menaxhmenti në trajtimin e këtij problemi dhe do të nxjerrim konkluzionet e duhura.</p>			
<p>3.7.3 Trajtimi i Llogarive të pagueshme</p>	<p>Kryetari të kujdeset që të gjitha faturat paguhen me kohë sipas kontratave dhe obligimet e mbetura pa paguar prezantohen saktë në raportet financiare të komunës. Kryetari duhet të rishikoj sistemin e menaxhimit të detyrimeve të papaguara, për t'iu shmangur ekzekutimin direkt të pagesave nga MF dhe gjykatat.</p>		<p>Pavarësisht kontrolleve të shtuar në këtë fushë , prapë mbetet nivel i lartë i borxheve.</p>	

Shtojca IV:Letër konfirmimi

KOMUNA –SUHAREKËS

OPSTINE SUVA REKA

THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA



24-C95-17

REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS REPUBLICA KOSOVA - OPŠTINA SUVA REKA REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA			
DËRGUIAR - DOSTAVLJENO - SENT			
Nr. Br. No.	Data Datum Date	Selia Sedište Hq.	Adresa Adresa Address
01-016-22571			Suhareka - Prizren

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit Vendi dhe data: **24.05.2017**

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Suharekës, për vitin 2016 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Kryetari:

Sali Asllanaj